

VENDIM
Nr. 171, datë 29.8.2024

MBI LISTËN E TARIFAVE TË ALPEX-it

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 3.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 8, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020; neneve 15 dhe 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1836 prot., datë 28.8.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 9.10.2023 ‘Mbi propozimin për miratimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Strukturës së Tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave’, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 50, datë 2.4.2024, si dhe vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.5.2024 ‘Mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX-it për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë’”,

konstatoi se:

- ERE me vendimin e Bordit nr. 287, datë 9.10.2023, ka miratuar listën e tarifave të ALPEX-it, të cilat do të aplikoheshin nga Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më datë 31.3.2024.

- Gjithashtu, në pikën 2, të dispozitivit të vendimit nr. 287/2023, Bordi i ERE-s vendosi: *Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), mbështetur në konstatimet e këtij vendimi.*

- Në konstatimet e vendimit nr. 287/2023, tarifat e miratuara me këtë vendim do të jenë të aplikueshme përkohësisht, deri në momentin e miratimit të tyre bazuar në një metodologji të strukturuar qartë ku të përcaktohet: **metoda e përlogaritjes së tarifave dhe periudha rregullatore.** Gjithashtu citojmë se: *Me fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), shoqëria ALPEX sh.a. duhet të vijojë me përditësimin e metodologjisë gjatë procesit konsultativ, në mënyrë që ERE të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin e saj.*

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 2.4.2024, vendosi shtyrjen e afatit të aplikimit të “Listës së tarifave të ALPEX-it” për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.8.2024.

- Metodologjia për përcaktimin e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), e përcjellë në ERE nga shoqëria ALPEX sh.a., është propozuar për miratim edhe pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës – ZRRE, në zbatim të nenit 6, pikave 6.1 dhe 6.4 të “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, të datës 21 tetor 2021. Meqenëse metodologjia është ende në proces shqyrtimi nga rregullatorët e të dyja vendeve, vlerësohet e nevojshme që tarifat e miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 9.10.2023 të qëndrojnë në fuqi deri më datë 31.12.2024, me qëllim garantimin e vijimit të ushtrimit të funksioneve operacionale të ALPEX sh.a. deri në finalizimin e procesit të

miratimit të “Metodologjisë së përcaktimit të tarifave” të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. *“Lista e tarifave të ALPEX-it”, të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 9.10.2023, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 50, datë 2.4.2024, do të aplikohet deri më 31.12.2024.*

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojnë shoqërinë ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti